



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Beqir Kalludra, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.J. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të datës 8 prill 2020, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1415/2018, të datës 5 mars 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 10 mars 2021, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit F.J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1415/2018, i datës 5 mars 2020, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin F.J. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK dhe ndaj të njëjtit për shkak të kësaj vepre penale ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 400 € (katërqind Euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor, i njëjti do t'i zëvendësohet me 20 (njëzet) ditë burgim, duke ja llogaritur çdo 20 € (njëzet Euro) me 1 (një) ditë burgim.

I dëmtuari B.S. nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Është detyruar i akuzuari F.J., që në emër të ekspertizës të ekspertit mjeko-ligjor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet Euro), në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i akuzuari F.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarin ta liroj nga akuza ose të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.1012/2020, të datës 22 tetor 2020, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Në ankesën e atë akuzuarit F.J. theksohet se aktgjykimin i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12. lidhur me nenin 370 paragrafët 6, 7 dhe 8 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP), pasi që dispozitivi i aktgjykimit në fjalë është i paqartë, i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin, si dhe me shkresat e lëndës. Gjithashtu, aktgjykimin i ankimuar i cili është përpiluar me shkrim nuk është në përputhje me aktgjykimin e shpallur, ashtu siç parashihet në nenin 370 paragrafi 1 të KPP. Po ashtu, në ankesë theksohet se aktgjykimin i ankimuar është përfshirë në shkeljet e lartcekura që i referohen nenit 245 paragrafi 4 të KPP, pasi që gjykata e shkallës së parë pa e mbajtur shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, ka kaluar në shqyrtim gjyqësor, duke mos i përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave dhe duke ia mohuar të akuzuarit të drejtën e tij në kundërshtimin e aktakuzës dhe provueshmërisë së provave të paraqitura në aktakuzë. Përveç këtyre, gjykata e shkallës së parë ka dështuar në respektimin e rregullave dhe parimeve fundamentale, që kanë të bëjnë me gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të të gjitha fakteve. Aktgjykimin i ankimuar përmban edhe shkelje të ligjit penal nga neni 385 të KPP, sepse në rastin konkret nuk është vërtetuar elementi i paramendimit dhe dashjes, ngase nuk ka as vepër penale të lëndimit të lehtë trupor. Edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, për shkak të qasjes jo objektive në lidhje me provat e administruara, në veçanti me ato të propozuara nga ana e të akuzuarit. Në vijim, i akuzuari në ankesën e tij i është referuar disa provave, të cilave sipas tij gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që t'ia falë

besimin, e përkundrazi është dashur që t'ia falë besimin provave të tjera duke përmendur deklarin e tij, deklarin e dëshmitarit M.B., deklarimeve të dëshmitarit Dr.N.K., si dhe disa provave të tjera materiale. Të gjitha këto kanë ndikuar që gjykata e shkallës së parë qartësisht ta vërtetoj në mënyrë të gabuar gjendjen faktike. Në fund edhe në lidhje me dënimin e shqiptuar, i akuzuari në ankesën e tij thekson se në këtë rast nuk ka vend për dënimin e shqiptuar sepse nuk ka as vepër penale. Gjykata e shkallës së parë fillimisht kishte aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren për dhënien e urdhrin ndëshkimor, ku të akuzuarit i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro), ndërsa, tani me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit i është shqiptuar dënim me gjobë prej 400 € (katërqind Euro) pa dhënë arsye se pse herën e parë është shqiptuar dënim me gjobë më të ulët se sa herën e dytë. Vlerësimet e gabuara janë bërë edhe te rrethanat rënduese pasi që si rrethanë rëndese është marrë për bazë përgatitja profesionale në lëmin e drejtësisë dhe i njëjti është dashur ta dijë se veprimin të cilin e ka kryer është veprim i kundërligjshëm. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, i akuzuari i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lartë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e të akuzuarit F.J. janë të pabazuara. Në radhë të parë, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me kurrfarë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesën e të akuzuarit F.J. dhe as në shkelje tjera të kësaj natyre për të cilat kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 nën-paragrafët 1.1.-1.3. të KPP. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar sipas ligjit, përkatësisht ashtu siç parashihet në nenin 370 të KPP. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i njëjti i përmban të gjitha elementet që parashihen me ligj. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, ndërsa në arsyetimin e të njëjtit, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale. Në rastin konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat prova janë analizuar dhe vlerësuar në mënyrë profesionale, pas vlerësimit të së cilave është ardhur në përfundim nëse faktet konkrete vendimtare janë vërtetuar ose jo. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me kredibilitetin e provave konkrete, të cilat janë vlerësuar si të besueshme dhe jo të besueshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, aktgjykimi i ankimuar siç

rezulton edhe nga shpresat e lëndës është në përputhje më aktgjykimin e shpallur. Në anën tjetër, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur në rastin konkret e ka caktuar drejtpërdrejtë shqyrtimin gjyqësor, pa e caktuar fare shqyrtimin fillestarë dhe shqyrtimin e dytë, për faktin se në nenin 496 paragrafi 4 të KPP, është parashikuar se *“Kur një gjyqtarë i vetëm nuk e hudhë kundërshtimin si të paafatshëm ose të paraqitur nga personi i paautorizuar, cakton shqyrtim gjyqësor lidhur me aktakuzën e prokurorit të shtetit”*. Nga shkresat e lëndës shihet që fillimisht, gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e datës 1 prill 2019, kishte aprovuar kërkesën e prokurorit të shtetit dhe kishte dhënë urdhër ndëshkimor, duke i shqiptuar të akuzuarit dënim më gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro), ndërsa pas kësaj i akuzuari me datën 12 prill 2019, ndaj aktgjykimi të lartcekur kishte paraqitur kundërshtim. Meqë nuk ishte hudhur ky kundërshtim, atëherë gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore ka caktuar drejtpërdrejtë shqyrtimin gjyqësor, andaj edhe në këtë drejtim, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se pretendimet ankimore të të akuzuarit nuk qëndrojnë, pasi që në raste të tilla, nuk duhet të caktohet shqyrtimi fillestar dhe as shqyrtimi i dytë, por duhet që drejtpërdrejtë të caktohet shqyrtimi gjyqësor. Përveç këtyre, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës gjatë shikimit të shkresave të lëndës nuk ka vërejtur që gjykata e shkallës së parë të ketë dështuar në respektimin e rregullave dhe parimeve fundamentale procedurale, siç pa të drejtë pretendohet në ankesë.

Në anën tjetër, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari F.J. është kryerës i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari F.J. në mënyrën e përshkruar më hollësisht në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, ngase i njëjti me datën 2 qershor 2018, rreth orës 14:00 minuta, në kafiterinë “Parki” e cila gjendet në Marash në Prizren, pasi që fillimisht fjalosen më të dëmtuarin B.S., në hapësirat e kafiterisë, të cilin pastaj e kap duke e rrëzuar për toke dhe e godit nëpër pjesë të ndryshme të trupit, të cilit i shkakton lëndime të lehta trupore, të përshkruara më përafërsisht si në akt ekspertimin mjeko ligjor të ekspertit Dr. F.S., me numër reference 09/2018 të datës 21 qershor 2018. Një gjendje e tillë faktike është vërtetuar nga deklaratimet e të dëmtuarit B.S., dëshmitarëve B.S.1 dhe Dr. N.K., provave materiale siç janë: ekspertiza mjeko ligjore e Dr. F.D. fotografive që gjenden në shkresat e lëndës, raporteve mjekësore, si dhe provave tjera. Duke u bazuar në të gjitha këto prova të cilat janë administruar, vlerësuar dhe analizuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por edhe në provat tjera që gjenden në shkresa të lëndës, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për shkak se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari F.J. e ka kryer veprën penale të lartcekur. Andaj, edhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në

të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon i akuzuari F.J. në ankesën e tij. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit F.J., i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale, i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Edhe sa i përket vendimit lidhur me dënimin, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura ankesën e të akuzuarit F.J. nuk qëndrojnë, për shkak se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ashtu siç parashihen në nenet 73 dhe 74 të KPRK. Kështu, gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese për të akuzuarin kishte marrë për bazë: rrethanat personale dhe faktin se është familjarë dhe ka fëmijë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar se i akuzuari ka përgatitje të larte profesionale në lëmin e drejtësisë dhe i njëjti është dashur ta dijë se veprimi të cilin e ka kryer është veprim i kundërligjshëm. Në lidhje me pretendimin ankimor të të akuzuarit F.J. që i referohet shqiptimit të dënimit me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind Euro) sipas aktgjykimit të ankimuar, në raport me dënimin me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro) që i është shqiptuar më parë sipas aktgjykimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsiston se një pretendim i tillë nuk qëndron për shkak se duke u bazuar në nenin 497 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e marrjes së aktgjykimit lidhur me kundërshtimin nuk është i detyruar me ndalesën nga neni 395 të KPP (*“Reformatio in Peius”*). Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe duke i pasur në konsideratë edhe rrethanat tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit F.J. është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të akuzuarit, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të tij. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.999/2020, me datën 10 mars 2020

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Kimete Veseli

---

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

---

Kryetare e kolegjit,  
Shqipe Qerimi

---

Beqir Kalludra

---